



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 26, datë 03.10.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT: “NDARJE STRUKTURE E NËNNJËSIVE  
HI.UB.3.1200, HI.UB.3.1199, HI.UB.3.1191, HI.UB.3.169 DHE HI.B.239, TË PLANIT TË  
PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË HIMARË”**

Në mbështetje të 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit: “Ndarje strukturore e nënnjësive HI.UB.3.1200, HI.UB.3.1199, HI.UB.3.1191, HI.UB.3.169 dhe HI.B.239, të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për pajisjen me leje ndërtimi dhe certifikate përdorimi për objektet që do të zhvillohen në ndarjet strukturore sipas Hartës së Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe sekretariati teknik i tij, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

